



INSTITUTI  
DEMOKRATIK  
I KOSOVËS



DEMOKRATIZIMI  
DHE PRAKTIKAT  
PARLAMENTARE



# RAPORT I MONITORIMIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2015

MARS 2016, PRISHTINË.

|||||

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	4
1. Hyrje .....	6
2. Komisionet parlamentare .....	7
3. Seancat e Kuvendit.....	15
3.1 Seancat plenare .....	15
3.2 Seancat e jashtëzakonshme.....	16
3.3 Seancat solemne .....	16
3.4 Pjesëmarrja e deputetëve në seanca.....	16
4. Përbushja e agjendës legislative .....	17
4.1 Projektligjet e miratuara .....	18
4.2 Reflektimi i prioriteteve të Qeverisë në agjendën legislative të Kuvendit .....	18
4.2 Projektligjet në procedurë .....	20
4.3 Projektligjet që nuk janë dorëzuar.....	20
5. Mbikëqyrja parlamentare .....	20
5.1 Pyetjet parlamentare .....	20
5.2 Interpelancat.....	23
5.3 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.....	23
5.4 Mbikëqyrja e organeve të pavarura.....	24
6. Lojaliteti ndaj grupit parlamentar .....	24
7. Udhëtimet e deputetëve jashtë vendit.....	25
8. Shpenzimet e Kuvendit .....	27
7. Përfundime dhe Rekomandime .....	29
Rekomandimet.....	30
ANEKSI 1: Statistikat e përgjithshme të komisioneve.....	34
ANEKSI 2: Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare .....	35
ANEKSI 3: Pyetjet parlamentare .....	39

Instituti Demokratik i Kosovës ka bërë vlerësimin e punës së Kuvendit për vitin 2015, vit ky i karakterizuar me kundërshtime të mëdha politike ndërmjet partive në pushtet dhe atyre në opozitë, që rezultuan me krizën më të madhe politike në vend. Kundërshtimi i marrëveshjes për krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe dhe Marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, kanë qenë pikat kulmore të këtyre përplasjeve. Bllokimi i seancave plenare, përdorimi i gazit lotsjellës, zhvillimi i seancave plenare në salla të improvizuara, shkeljet e procedurave dhe praktikave parlamentare, miratimi i ligjeve pa debat të mirëfilltë parlamentar, përjashtimi kolektiv i deputetëve të opozitës, arrestimet e deputetëve janë disa nga emëruesit e përbashkët që kanë përcjellë Kuvendin përgjatë vitit 2015.

Tremujori i parë i punës së Kuvendit është shoqëruar me dinamikë jashtëzakonisht të ulët të punës, me vetëm një projektligj të miratuar, atë për buxhetin. Kjo dinamikë e ulët i atribuohet Qeverisë, pasi nuk e kishte sjellë fare në Kuvend agjendën legjislative në këtë periudhë. Në pjesën e dytë të sesionit pranveror, Kuvendi ka intensifikuar dinamikën duke arritur të miratojë në lexim të dytë 16 projektligje, përderisa 25 projektligje të tjera ishin në procedurë të komisioneve parlamentare. Për afër tre muaj, të gjitha punimet e Kuvendit janë bojkotuar nga deputetët e “Listës Serbe” (nga data 3 shkurt deri më 27 prill), si shenjë kundërshtimi ndaj qeverisë për shkarkimin e shefit të tyre Aleksandër Jabllanoviç nga pozita e ministrit për Komunitete dhe për Kthim.

Sfidat tjera më të cilat është ballafaquar Kuvendi në sesionin pranveror kanë qenë në raport me agjencitë e pavarura dhe kontrollin parlamentar të qeverisë. Organet udhëheqëse të Agjencive të Pavarura dhe Ndërmarrjeve Publike vazhduan të mbesin jofunksionale si pasojë e moskompletimit me anëtarë. Qeveria ka neglizhuar propozimin e anëtarëve sipas kompetencave të saj kurse Kuvendi nuk ka bërë presion ndaj qeverisë që të bëjë propozimet për të funksionalizuar këto institucione. Me gjithë dinamikën e shtuar të Kuvendit në kontekstin e plotësimit të bordeve, deri në përfundim të sesionit pranveror gjashtë Agjenci të pavarura kanë qenë me borde të pakompletuara, dy prej të cilave nuk kishin fare borde si pasojë e skadimit të mandateve apo edhe mos konstituimit që nga koha e themelimit.

Urgjenca e Qeverisë së Kosovës për të proceduar projekt-ligje me procedurë të përsheptuar ka qenë e shpeshtë në Kuvend. Përveç miratimit të buxhetit, procedura të përsheptuara janë ndjekur edhe me rastin e rishikimit të buxhetit dhe tri ligjeve tjera që kanë dal nga themelimi i Gjykatës Speciale. Jashtë praktikave parlamentare janë rikthyer në Kuvend për miratim edhe amandamentet që mundësojnë themelimin e kësaj gjykate, pasi që Kuvendi kishte votuar një herë kundër tyre. Kjo praktikë jo e mirë parlamentare e shmangies së Rregullores së Kuvendit, ka filluar të instalohet si kulturë e shpeshtë në Kuvendin e Kosovës. Miratimi i ligjeve me procedurë të përsheptuar (duke shmangur Rregulloren) po pengon shqyrtimin e mirëfilltë të legjislacionit dhe në fund po rezulton me ligje dhe dokumente me defekte të mëdha në përmbajtjen e tyre dhe në disa raste dhe të pa zbatueshme në praktikë.

|||||

### *Kuvendi në procesin e dialogut me Serbinë*

Mungesa e transparencës në procesin e dialogut me Serbinë, më saktësisht nënshkrimi i marrëveshjes së parimeve të përgjithshme për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë, ishte momenti i thyerjeve të mëdha ndërmjet partive në pushtet dhe atyre opozitare që rezultuan me bllokim të seancave plenare dhe bojkotim të mbledhjeve të komisioneve parlamentare nga deputetët e subjekteve politike opozitare.

### *Kuvendi në seancat e gazit dhe përjashtimet*

Përgjatë gjithë sesionit vjeshtor (22 shtator – 17 dhjetor), deputetët opozitarë penguan mbajtjen e seancave plenare me përdorimin e gazit lotsjellës në ambientet e brendshme të Kuvendit. Seancat solemne dhe ajo për ratifikimin e marrëveshjes për MSA-në nuk u penguan të mbahen. Kjo periudhë ka qenë ndër më të rëndat e parlamentarizmit në Kosovë dhe seriozisht ka sfiduar funksionalitetin institucional. Kryetari i Kuvendit ndonëse fillimisht kishte hezitur të përdorë kompetencat e përcaktuara me Rregulloren të Punës së Kuvendit – intervenimin e policisë - për të larguar nga punimet e Kuvendit deputetët të cilët pengojnë mbarëvajtjen e punimeve, pas presioneve të Kryesisë një masë kishte filluar të gjejë zbatim të tepruar në vetë sallën e seancave. Përkundër kësaj dhe kontrolleve të shtuara të deputetëve, sigurimi i Kuvendit kishte dështuar të parandaloj futjen e gazit lotsjellës në ambientet e brendshme.

Improvizimi i një salle në katin e sipërm të ndërtesës së Kuvendit, ishte parë si zgjidhje për të vazhduar seancat plenare pas shqiptimit të masës së largimit kolektiv të deputetëve opozitar dhe pengimit fizik të tyre nga ana e policisë që t'i afrohen kësaj salle. Meqenëse përdorimi i gazit lotsjellës nga persona të paautorizuar cilësohet si vepër penale dhe deputetët sipas aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese bartin vetëm imunitet funksional, ka bërë që prokuroria të urdhëroj arrestimin e deputetëve. Deri në përmbyllje të punës së Kuvendit, bilanci i arrestimeve, shoqërimeve në polici, paraburgimeve dhe masës së arrestit shtëpiak ishte në 13 deputetë opozitar.

Taktizime të shumta janë bërë nga Kryesia e Kuvendit për të siguruar mbajtjen e seancave plenare. Seanca e fundit është shoqëruar me shkelje serioze që përfshijnë ndalimin e deputetëve të subjekteve politike opozitare që të marrin pjesë në vazhdimin e seancës plenare. Përkundër që në fillim të kësaj seance të nisur me datë 14 dhjetor 2015, ka qenë në fuqi masa disiplinore e largimit të deputetëve nga mbledhjet e asaj dite në Kuvend, një masë e tillë nuk ka qenë valide për ditët tjera. Rregullorja e Punës së Kuvendit e thotë këtë qartë në Nenin 41.3 për sjelljet jo parlamentare të deputetëve se largimi bëhet nga “... mbledhja e Kuvendit ose nga mbledhja e komisioneve të asaj dite”. Politizimi i bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura ka qenë më i shprehur gjatë pjesës së dytë të vitit.


|||||

Monitorimi i punës së Kuvendit nga organizata të pavarura joqeveritare, ka për qëllim të rrisë transparencën e institucionit më të lartë ligjvënës karshi zgjedhësve/qytetarëve. KDI synon që përmes monitorimit të shpërfaqë dhe sanojë mangësitë në punën e administratës apo trupave punuese të Kuvendit. Për më tepër, monitorimi ka për qëllim rritjen e nivelit të llogaridhënies së të zgjedhurve karshi zgjedhësve dhe të shërbejë si shtysë që Kuvendi të përmbushë sa më shumë planin e punës. Duke përcjellur përmbushjen e agjendës legislative synohet të rritet efikasiteti legjislativ i Kuvendit, ndërsa përmes monitorimit të shpenzimeve të Kuvendit dhe të deputetëve individualisht, synohet të ndikohet në racionalizimin e shpenzimeve publike.

Pjesa e parë e këtij raporti i dedikohet punës së komisioneve parlamentare, ku ndër të tjera në formë tabelare janë prezantuar mungesat e deputetëve në këto komisione. Pjesa e dytë e raportit i dedikohet zhvillimeve në seanca të Kuvendit dhe përmbushja e planit të punës së Kuvendit në përgjithësi. Një theks më të madh këtu i kemi dhënë përmbushjes së agjendës legjislative, të ndarë edhe në bazë të sektorëve më prioritarë. Mbikëqyrja parlamentare është në pjesën përmbyllëse të këtij raporti, ku janë prezantuar dhe analizuar pyetjet parlamentare, interpelancat, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe agjencive të pavarura.

Kriza politike që ka afektuar Kuvendin pashmangshmërisht ka ndikuar edhe rezultatet e monitorimit. Kjo për shkak se bojkotimin që opozita i ka bërë komisioneve parlamentare, ka ndikuar në përformancë të dobët të komisioneve, trajtim sipërfaqësor të tematikave të ndryshme e rrjedhimisht edhe çështjet të cilat kemi pasur për qëllim që t'i monitorojmë kanë qenë shumë më të pakta në numër. Në anën tjetër, pengimi i mbarëvajtjes së seancave plenare rezultoi në numër të vogël të seancave të mbajtura, disa nga to në salla të improvizuara dhe shqyrtim të pikave të rendit të ditës sa për t'i konsumuar e që jo radhë herë rezultuan me miratim të ligjeve pa verifikuar nëse janë të plota. Rasti më flagrant është ai i miratimit i Ligjit për Prokurimin Publik, ku nene të rëndësishme që kanë të bëjnë me emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të OSHp-së u harruan tërësisht nga ngutia e miratimit të ligjit.

Puna në komisionet parlamentare, si trupa ndihmëse të Kuvendit është tejet e rëndësishme për efikasitetin e përgjithshëm të institucionit më të lartë legjislativ. Gjithsesi, puna e komisioneve parlamentare gjatë vitit 2015 ka hasur në ngecje. Fillimi i legjislaturës së V-të u shënuar me ngërç gjashtëmujor, për të vazhduar më pastaj me pengimin e mbajtjes së seancave të Kuvendit dhe bojkotimit të mbledhjeve të komisioneve në pjesën e dytë të vitin 2015. Që nga konstituimi i kësaj legjislature vetëm në pjesën e parë të vitit (sesionin pranveror) Kuvendi ka funksionuar normalisht, por që është shoqëruar me një dinamikë të ulët të punës.



Kategoria	Numri
Dëgjime publike	38
Mbledhje të komisioneve	419

Gjatë këtij viti komisionet e Kuvendit të Kosovës kanë mbajtur gjithsej 419 mbledhje të rregullta dhe 38 dëgjime publike. Nga dëgjimet publike tetë kanë qenë në bashkëpunim me partnerë të jashtëm. Puna e komisioneve parlamentare ka qenë dukshëm më e madhe në sesionin pranveror, krahasuar me sesionin vjeshtor. Disa komisione kanë qenë shumë pasive gjatë sesioni vjeshtor, duke zhvilluar kështu jo më shumë se 2 mbledhje për një sesion. Dallimi është vërejtur edhe në mbajtjen e dëgjimeve publike. Nga gjithsej 38 dëgjime publike sa janë mbajtur, vetëm gjashtë prej tyre i takojnë sesionit vjeshtor.

Përgjatë vitit 2015, 14 komisionet parlamentare dhe një nën-komision kanë punuar gjithsej 498 orë e 94 minuta. Nga kjo prinë Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit me 93 orë e 8 minuta punë, pasuar nga Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me 59 orë e 22 minuta, dhe Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport me 54 orë e 62 minuta, që plotësojnë tre komisionet me numrin më të madh të orëve të punës brenda një viti. Kurse komisionet me më së paku orë pune gjatë vitit 2015 janë Mbikëqyrja e Agjensionit Kosovar për Intelegjencë me 12 orë e 8 minuta, Komisioni për Punë të Jashtme me 14 orë e 53 minuta, dhe Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës

Nr.	Emërtimi i komisionit	Orët e punës
1	Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit	93.8
2	Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	59.22
3	Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	54.62
4	Buxhet dhe Financa	38.28
5	Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor	30.87
6	Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	29.37
7	Të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	28.42
8	Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	28.35
9	Mbikëqyrja e Financave Publike	27.33
10	Integritet Evropian	27.22
11	Të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	26.47
12	Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë	25.33
13	Punë të Jashtme	14.53
14	Mbikëqyrja e Agjencionit Kosovar për Integritet	12.8
15	Nën-Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit	2.33

Rregullorja e Kuvendit po ashtu autorizon komisionet të mbikëqyrin zbatimin e ligjeve nga Qeveria, përkatësisht nga ministria, për ligjet brenda fushës së përgjegjësisë së komisionit. Edhe në këtë aspekt, shumica e komisioneve parlamentare kanë shënuar sukses në monitorim të zbatimit të ligjeve specifike mirëpo kishte edhe raste kur disa komisione parlamentare nuk arritën të kryenin monitorimin e zbatimit të ligjeve të fushë-veprimtarisë së një komisioni të caktuar.

Shumica e komisioneve parlamentare kanë organizuar dëgjime publike gjatë vitit 2015. Megjithatë një gjë e tillë nuk është e obligueshëm për Komisionet, organizimi i dëgjimeve publike është një praktikë e mirë e cila ngritë nivelin e mbikëqyrjes parlamentare dhe garanton llogaridhënien, element ky i domosdoshëm për funksionimin demokratik të institucioneve.

[illegible]



**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Naser Osmani	23	6	29	12
Safete Hadergjona	21	4	25	16
Jelena Bontic	5	3	8	14
Bali Muharremaj	14	2	16	12
Bardhyl Meta	20	5	25	16
Besa Gaxherri	23	6	29	12
Enver Hoti	14	1	15	19
Fikrim Damka	20	5	25	16
Ilir Deda	11	1	12	16
Labinotë Murtezi	24	6	30	11
Latif Gashi	25	6	31	10

Ministrin e Financave Avdullah Hoti, i cili i është përgjigjur ftesës së komisionit nëntë herë duke raportuar për çështje të ndryshme. Deputeti me më së shumti mungesa ka qenë Enver Hoti i cili ka munguar në 19 nga 41 mbledhje të komisionit. Deputeti me pjesëmarrjen më të lartë është Latif Gashi, i cili ka munguar në 10 mbledhje.

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Jasmina Zivkovic	14	7	21	9
Agim Ceku	16	3	19	11
Mufera Sinik	17	6	23	7
Agim Kikaj	17	6	23	7
Cerim Bajrami	17	4	21	9
Danush Ademi	16	7	23	7
Fisnik Ismaili	14	2	16	14
Milka Vuletic	8	3	11	19
Rrustem Berisha	6	1	7	15
Slavko Simic	9	5	14	16
Veton Berisha	17	7	24	6
Sasa Milosavljevic	14	1	15	15

gjithsej 19 mungesa.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka zhvilluar gjithsej 41 takime. Në sesionin pranveror janë të shënuara 25 mbledhje, ndërsa në sesionin vjeshtor 16. Ky komision nuk ka zhvilluar asnjë dëgjim publik, mirëpo ka qenë mjaftë aktiv në shqyrtimin e projektligjeve. Duke qenë komision i përhershëm, ka shqyrtuar 49 projektligje, 30 projektligje janë shqyrtuar në sesionin pranveror, ndërsa 19 në sesionin vjeshtor. Komisioni ka monitoruar vetëm një ligj dhe ka ftuar për raportim vetëm

Ky komision ka mbajtur 30 takime, prej tyre 18 në sesionin pranveror dhe 12 në sesionin vjeshtor. Komisioni ka shqyrtuar gjithsej 41 projektligje dhe ka bërë monitorimin e katër ligjeve. Komisioni ka mbajtur vetëm një dëgjim publik. Ministrat që kanë raportuar në këtë komision janë: Arsim Bajrami (MASHT) dy herë, Hajredin Kuçi një herë (MD) dhe Dalibor Jevtic (MKK) një herë. Deputeti më i rregullt në komision ka qenë Veton Berisha i cili ka munguar në gjashtë nga 30 mbledhjet e komisionit, ndërsa Milka Vuletic ka pasur pjesëmarrjen më të ulët me

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Albulena Haxhiu	30	2	32	16
Selvije Halimi	29	10	39	9
Danush Ademi	30	10	40	8
Agim Aliu	28	9	37	11
Agim Ademaj	29	10	39	9
Armend Zemaj	30	9	39	9
Donika Kadaj Bujupi	16	2	18	16
Doruntinë Kastrati Maloku	20	9	29	19
Milena Milicevic	14	7	20	28
Nezir Cocaj	29	10	39	9
Valdete Bajrami	0	0	0	0

Komisioni ka zhvilluar gjithsej 44 mbledhje, prej të cilave 33 janë mbajtur gjatë sesionit pranveror dhe 15 në sesionin vjeshtor. Ky komision ka shqyrtuar 44 projektligje, ndërsa ka bërë monitorimin e një ligji. Vetëm një dëgjim publik është zhvilluar gjatë gjithë vitit. Raportimi i vetëm nga kabineti qeveritar në komision është bërë nga Edita Tahiri – Ministre për Dialog. Deputeti më i rregullt ka qenë Danush Ademi, ndërsa me numrin më të vogël të pjesëmarrjes është Milena

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Teuta Sahatqija	24	6	28	6
Valdete Bajrami	21	0	21	13
Slobodan Petrovic	9	5	14	20
Arben Gashi	17	7	24	10
Ilir Deda	24	4	28	6
Kujtim Pacaku	18	3	21	13
Luljeta Veselaj Gutaj	23	7	30	4
Rrustem Mustafa	20	5	25	9
Time Kadrijaj	13	1	14	20
Vjosa Osmani Sadriu	14	6	20	14
Xhavit Haliti	15	3	18	16

Komisioni për Integritet Evropian ka zhvilluar 34 takime dhe dy dëgjime publike. Nga takimet e mbajtura 25 janë në sesionin pranveror dhe 9 në sesionin vjeshtor. Komisioni ka bërë shqyrtimin e 41 projektligjeve, dhe monitorimin e dy ligjeve të tjera. Ministrat që kanë raportuar në komision janë: Skender Hyseni (MPB), Hykmete Bajrami (MTI), Hajredin Kuçi (MD), Mahir Yagcilar (MAP) dhe Bekim Collaku (MIE). Deputetja më e rregullt nëpër mbledhjet e komisionit ka qenë Luljeta Veselaj – Gutaj me vetëm katër mungesa në 34 mbledhje, ndërsa deputetët që kanë munguar më së shumti janë Slobodan Petrovic dhe Time Kadrijaj, të cilët kanë marrë pjesë

**Komisioni për Punë të Jashtme**

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Enver Hoxhaj	9	2	11	9
Teuta Rugova	8	3	11	9
Cerim Bajrami	8	2	10	10
Blerta Deliu - Kodra	10	3	13	7
Elmi Reçica	9	3	12	8
Glauk Konjufca	0	0	0	0
Ismet Beqiri	7	2	9	11
Ramush Haradinaj	7	1	8	12
Zafir Berisha	8	2	10	10
Puhie Demaku	7	2	9	11

Komisionin për Punë të Jashtme kanë qenë Valon Murati (MDi) dhe Edita Tahiri – Ministre për Dialog. Deputetja më e rregullt në mbledhjet e komisionit ka qenë Blerta Deliu – Kodra me mungesën në vetëm shtatë mbledhje, ndërsa deputeti me më së shumti mungesa në mbledhje të komisionit ka qenë Ramush Haradinaj me 12 mungesa nga 20 mbledhjet e mbajtura.

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Nait Hasani	19	12	31	4
Salih Morina	19	12	31	4
Serdjan Popovic	4	10	14	7
Bekim Haxhiu	19	8	27	8
Ismajl Kurteshi	19	3	20	15
Mufera Sinik	14	10	24	11
Shpejtim Bulliqi	18	11	29	6
Shukrije Bytyqi	18	2	20	15
Teuta Haxhiu	19	3	22	13
Jelena Bontic	5	/	5	

Shala (MKRS) dy herë, Valon Murati (MDi) një herë dhe Mahir Yagcilar (MAP) një herë. Deputetët më të rregullt në mbledhjet e komisioneve janë Nait Hasani dhe Salih Morina me nga katër mungesa në 35 mbledhje të komisionit ndërsa më pak të rregullt sa i përket pjesëmarrjes nëpër mbledhje kanë qenë Ismajl Kurteshi dhe Shukrije Bytyqi të cilët kanë munguar në 15 nga 35 mbledhjet.

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Me një total prej 43 takimesh për një vit ky komision cilësohet si më aktiv nga të gjitha komisionet e Kuvendit. Gjatë vitit 29 takimet janë mbajtur në sesionin pranveror dhe 14 të tjera në sesionin vjeshtor. Komisioni ka shqyrtuar 10 projektligje kurse tri projektligje të tjera kanë mbetur në

Komisioni për Punë të Jashtme ka zhvilluar gjithsej 20 mbledhje brenda vitit 2015. Në këtë mënyrë, ky Komision ka dështuar të respektoj Rregulloren e Kuvendit sa i përket kërkesës së mbajtjes së mbledhjeve të Komisionit, të paktën dy për çdo muaj. Në sesionin pranveror janë zhvilluar 14 mbledhje, kurse në atë vjeshtor 6. Ky komision nuk ka zhvilluar asnjë dëgjim publik, ka shqyrtuar një projektligj, dhe ka bërë monitorimin e një ligji. Ministrat raportues në

Ky komision ka zhvilluar gjithsej 35 takime gjatë vitit 2015. Sesionit pranveror i përketin 22 takime, ndërsa sesionit vjeshtor 13 prej tyre. Komisioni ka qenë aktiv sa i përket dëgjimeve publike, me gjithsej 11 dëgjime publike të mbajtura brenda vitit. Ka shqyrtuar 10 projektligje, dhe ka bërë monitorimin e dy ligjeve. Në procedurë të monitorimit janë pesë ligje të tjera. Ministrat që kanë raportuar në këtë komision janë: Arsim Bajrami (MASHT) gjashtë herë, Kujtim

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Muhamet Mustafa	28	13	41	2
Visar Ymeri	22	1	23	20
Sasa Milosavljevic	16	8	24	19
Besim Beqaj	22	11	33	10
Blerim Grainca	27	11	38	5
Duda Balje	17	9	26	17
Enver Hoti	18	2	20	23
Fatmir Rexhepi	21	11	32	11
Pal Lekaj	22	1	23	20
Raif Qela	28	13	41	2
Sala Berisha Shala	26	13	39	4

mbledhje.

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Flora Brovina	16	5	21	2
Njomza Emini	14	2	16	7
Fikrim Damka	14	4	18	5
Adem Hodza	4	5	9	14
Besa Baftiu	16	2	18	5
Fadil Beka	17	5	22	1
Hatim Baxhaku	14	5	19	4
Shukrije Bytyqi	17	2	19	4
Time Kadrijaj	16	2	18	5

në procedurë. Komisioni ka mbajtur edhe tri dëgjime publike këtë vit. Ministrat që kanë raportuar në komision janë: Arban Abrashi (MPMS) dy herë, dhe Imet Rrahmani (MSH) tri herë. Deputeti më i rregullt është Fadil Beka që ka marrë pjesë në 22 nga 23 mbledhjet e komisionit, ndërsa deputeti me pjesëmarrjen më të ulët në takime është Adem Hodza i cili ka munguar në 14 nga 23 mbledhjet.

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Zenun Pajaziti	14	8	22	8
Sadri Ferati	15	8	23	7
Kujtim Paçaku	12	8	20	10
Alma Lama	10	8	18	12
Jelena Bontic	8	3	11	19
Pal Lekaj	9	2	11	19
Shqipe Pantina	14	2	16	14

|||||

Xhevahire Izmaku	15	8	<b>23</b>	7
Zafir Berisha	11	0	<b>11</b>	19

Ky komision ka mbajtur 30 takime, nga të cilat 22 janë

në sesionin pranveror, dhe tetë në sesionin vjeshtor. Komisioni ka shqyrtuar tri projektligje, dhe është në procedurë të monitorimit të tri ligjeve të tjera. Ky komision ka mbajtur pesë dëgjime publike. Ministri i vetëm që ka raportuar në këtë komision është Mahir Yagcilar, i cili ka qenë i pranishëm tri herë brenda vitit. Deputetët më të rregullt kanë qenë Sadri Ferati dhe Xhevahire Izmaku të cilët kanë munguar në shtatë nga 30 mbledhjet e komisionit, ndërsa interesim më të vogël për takimet kanë treguar Jelena Bontic dhe Pal Lekaj që kanë munguar në 19 mbledhje.

#### Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Fikrim Damka	19	5	<b>24</b>	2
Salih Salihu	14	2	<b>16</b>	10
Serdjan Popovic	3	5	<b>8</b>	18
Adem Salihaj	5	5	<b>10</b>	16
Emilija Redzepi	5	3	<b>8</b>	18
Haxhi Shala	3	1	<b>4</b>	22
Lahi Brahimaj	1	1	<b>2</b>	24
Murat Hoxha	1	4	<b>5</b>	21
Shaip Muja	4	5	<b>9</b>	15
Velimir Rakic	5	0	<b>5</b>	21

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor ka zhvilluar 26 takime, prej të cilave 19 në sesionin pranveror dhe shtatë në sesionin vjeshtor. Komisioni ka shqyrtuar një projektligj, dhe ka bërë monitorimin e një ligji. Nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik. Ministri i vetëm që ka raportuar në komision është Memli Krasniqi (MB).

Ndonëse në limitet e parapara, megjithatë mund të konstatohet se ky komision ka përmbushur detyrat e veta që i parasheh Rregullorja e Kuvendit. Deputeti më i rregullt është Fikrim Damka me vetëm dy mungesa në 26 mbledhje, ndërsa deputeti që ka munguar më së shumti në mbledhjet e komisionit është Lahi Brahimaj i cili ka munguar 24 herë nga 26 mbledhjet.

#### Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Daut Haradinaj	18	1	<b>19</b>	6
Fadil Demaku	16	4	<b>20</b>	5
Bojan Mitic	7	4	<b>11</b>	14
Anton Cuni	14	4	<b>18</b>	7
Cerim Bajrami	18	4	<b>22</b>	3
Ganimete Musliu	15	4	<b>19</b>	6
Nuredin Ibishi	17	4	<b>21</b>	4
Rexhep Selimi	12	1	<b>13</b>	12
Zafir Berisha	18	1	<b>19</b>	6

Brenda një viti, komisioni ka zhvilluar 25 takime, prej tyre 21 në sesionin pranveror dhe katër në sesionin vjeshtor. Ky komision ka shqyrtuar katër projektligje dhe ka bërë monitorimin e një ligji. Numri i dëgjimeve publike të mbajtura është tri. Ministrat që kanë raportuar në komision janë: Skënder Hyseni (MPB) dhe Haki Demolli (MM). Sipas pjesëmarrjes nëpër takime,

deputeti më i rregullt është Cerim Bajrami i cili ka munguar në vetëm tri nga 25 mbledhjet e komisionit ndërsa ai me më së paku prezenca është Bojan Mitic me 14 mungesa nga 25 mbledhje.

#### Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Gjithsej 21 takime ka zhvilluar Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në vitin 2015, numër më i vogël sesa ai i paraparë nga Rregullorja e Kuvendit sa i përket takimeve që duhet mbajtur një

|||||

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Besnik Bislimi	7	1	8	13
Ali Sadriu	12	6	18	3
Duda Balje	9	6	15	6
Adem Grabovci	11	6	17	4
Bali Muharremaj	12	2	14	7
Valdete Bajrami	4	1	5	16
Hajdar Beqa	13	6	19	2
Naim Fetahu	11	6	17	4
Synavere Rysha	12	6	18	3

rekomandime. Komisioni ka mbajtur tri dëgjime publike. Ministrat që kanë raportuar në komision janë: Mahir Yagcilar (MAP) dy herë, Bekim Çollaku (MIE), Ferid Agani (MMPH), Arban Abrashi (MPMS) dhe Avdullah Hoti (MF). Deputetët më të rregullt kanë qenë Hajdar Beqa dhe Synavere Rysha me vetëm nga tri mungesa, ndërsa me më së paku pjesëmarrje janë Valdete

Pjesëmarrja e deputetëve në takime				
Emri dhe Mbiemri	Sesioni pranveror	Sesioni vjeshtor	Gjithsej	Mungesa
Lirije Kajtazi	20	7	27	1
Salihe Mustafa	20	8	28	0
Nenad Rasic	0	2	2	0
Etem Arifi	16	7	23	5
Kujtim Paçaku	18	7	25	3
Mexhide Mjaku Topalli	20	7	27	1
Mytaher Haskuka	19	1	20	8
Teuta Haxhiu	16	2	18	10
Valdete Bajrami	14	2	16	12

Komisioni ka zhvilluar 28 takime gjatë vitit 2015, nga të cilat 20 janë mbajtur në sesionin pranveror dhe tetë në sesionin vjeshtor. Komisioni ka shqyrtuar në parim pesë projektligje dhe ka bërë monitorimin e një ligji. Ndërkaq komisioni nuk ka zhvilluar asnjë dëgjim publik. Asnjë ministër nuk ka raportuar në komision.

Gjatë vitit 2015 komisioni ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje, numër shumë më i vogël sesa ai i paraparë me Rregulloren e Kuvendit. Në fakt, ky komision ka mbajtur më së paku mbledhje për vitin 2015 nga të gjitha komisionet tjera në Kuvendin e Kosovës. Në sesionin pranveror janë mbajtur 12 mbledhje, ndërsa në sesionin vjeshtor dy. Ky komision nuk ka shqyrtuar ndonjë projektligj, dhe nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik. Komisioni është në procedurë të monitorimit të një ligji. Duke genë se mbledhjet

e këtij komisioni janë të mbyllura dhe nuk publikohen procesverbalet nuk ka qenë e mundur të verifikohet pjesëmarrja e deputetëve, apo e raportimit të ministrave në këtë komision.


### Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Nën-komisioni ka zhvilluar 10 takime, me gjithsej 12 pika të rendit të ditës dhe ka mbajtur një punëtori.

## 3. SEANCAT E KUVENDIT

Kuvendi gjatë vitit 2015 ka mbajtur 31 seanca plenare, në 20 raste është vazhduar seanca për ditën tjetër, pesë seanca kanë qenë të jashtëzakonshme dhe nëntë seanca të tjera solemne. Viti 2015 do të mbahet në mend si viti që solli seanca të vezëve e gazit lotsjellës, forma të protestës të përdorura nga partitë opozitare për të kundërshtuar marrëveshjen e arritur në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe si dhe Marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Shumica e seancave të mbajtura gjatë sesionit vjeshtor u mbajtën në salla të improvizuara dhe pa praninë e deputetëve opozitar. Projektligjet u votuan me procedurë të përshpejtuar dhe pikat ku kërkohej votimi me shumicë të dyfishtë hiqeshin nga rendi i ditës. Skena të tilla nuk kishin ndodhur asnjëherë më parë në seanca të Kuvendit të Kosovës.

**Seancat gjatë vitit 2015**



**Grafiku 2: Seancat e Kuvendit për vitin 2015**

### 3.1 SEANCAT PLENARE

Kuvendi ka mbajtur gjithsej 31 seanca plenare dhe 20 seanca tjera që kanë qenë vazhdime të seancave. Në sesionin pranveror janë mbajtur 26 seanca plenare. Kurse gjatë sesionit vjeshtor, seancat plenare janë penguar të mbahen nga deputetët e subjekteve politike opozitare. Edhe ato pak seanca që janë mbajtur që gjithsej janë pesë, janë mbajtur në kushte të jashtëzakonshme apo salla të improvizuara brenda ndërtesës së Kuvendit. Deputetët e opozitës kanë hedhur gaz lotsjellës në sallën e Kuvendit me qëllim të pengimit të mbajtjes së seancave në shenjë të kundërshtimit të marrëveshjes për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe, si dhe marrëveshjes për përcaktimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Në këto seanca morën pjesë vetëm deputetët e partive në pushtet pasi që Kryesia e Kuvendit mori vendim për përjashtimin kolektiv të deputetëve opozitarë.



### 3.2 SEANCAT E JASHTËZAKONSHME

Ndërsa, në sesionin vjeshtor është mbajtur një seancë e jashtëzakonshme në të cilën u bë shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

### 3.3 SEANCAT SOLEMNE


Gjatë vitit 2015 Kuvendi ka mbajtur nëntë seanca solemne. Këto seanca janë mbajtur për këto raste: Dita e Pavarësisë së Kosovës, Dita e Gruas, Kushtetuta e Kaçanikut, Dita e te pagjeturve, Dita e pages, Jeta dhe Vepra e Isa Boletinit (e organizuar me rastin e rivarrimit të tij), Vizita e Presidentit të Austrisë, z. Heinz Fischer, vizita e Komisionarit të UE-së, z. Johanes Han dhe Adresimi i Presidentes Jahjaga ndaj deputetëve të Kuvendit. Vlen të përmendet fakti se seancat solemne ishin të vetmet ku morën pjesë edhe deputetët e partive opozitare.

### 3.4 PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA

Megjithatë, situatë tjetër mbretëronte gjatë sesionit pranveror. Gjatë kësaj kohe, derisa deputetët e opozitës merrnin pjesë në seanca, tendencë më të madhe të mungesës në seanca plenare kishin deputetët e partive nga koalicioni qeverisës. Në këtë aspekt, më së shumti mungesa për vitin 2015 shënuan deputetët e Listës Serbe.




|||||



**Grafiku 3:** Mungesat e deputetëve në seanca sipas muajve

#### Mungesat sipas grupeve parlamentare



**Grafiku 4:** Mungesat e deputetëve në seanca sipas grupeve parlamentare

## 4. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE

Kuvendi gjatë vitit 2015 ka miratuar 47 projektligje (34%) nga gjithsej 137 të parapara për këtë vit. Nga ligjet e miratuara, 13 kanë qenë ligje të sjella për plotësim nga Qeveria. Në procedurë të komisioneve parlamentare kanë mbetur në shqyrtim edhe 23 projektligje (17%), kurse 67 projektligje tjera (49%) nuk janë dorëzuar fare në Kuvend nga Qeveria. Ngecja më e madhe sa i përket programit legjislativ të për vitin 2015 vërehet gjatë sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit, ku shumica absolute e projektligjeve të parapara kanë mbetur të pashqyrtuara. Mos përmbushje të agjendës legjislative haset edhe gjatë sesionit pranveror, edhe pse gjatë këtij sesiioni Kuvendi ka zhvilluar normalisht punën e tij. Megjithatë, për shkak të krizës politike të krijuar pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014, agjenda legjislative e vitit 2014 nuk ishte përmbushur dhe kështu shumë projektligje të parapara për vitin 2014 janë shqyrtuar në sesionin pranveror të punës së Kuvendit në vitin 2015.


Ndonëse agjenda legjislative gati kryekëput varet nga planifikimet e qeverisë, bazuar në performancën e viteve paraprake, Kuvendi do të duhej të shqyrtonte me kujdes këtë agjendë para se të aprovojë si bazë për punën e tij vjetore. Mbi-planifikimi ose agjendat legjislative ambicioze (dukuri që po e përcjell

|||||

Edhe projektligjet e pakta të shqyrtuara gjatë vitit 2015 nuk u proceduan në mënyrën më të mirë të mundshme. Këtë vit është vërejtur dukuria e miratimit të projektligjeve në procedurë të përshpejtuar përgjatë dy sesioneve. Ndonëse një gjë e tillë nuk paraqet shkelje të Rregullores së Punës, megjithatë mbetet një praktikë e keqe e cila nuk duhet assesi të zbatohet në të ardhmen. Në fillim të vitit dinamika e punës ka qenë e ulët. Gjatë tre muajve të parë janë miratuar tre ligje dhe atë me procedurë të përshpejtuar si dhe janë ratifikuar dy marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa pjesa tjetër e sesionit pranveror ka vazhduar me punë më dinamike. Gjithsej në sesionin pranverorë janë miratuar 29 ligje. Sesioni vjeshtor është përcjellë me tensione dhe dinamikë sporadike. Projektligjet janë shqyrtuar dhe miratuar pa praninë e opozitës dhe pa debat të mirëfilltë parlamentar. Në sesionin vjeshtor janë miratuar 18 ligje.

#### 4.1 PROJEKTLIGJET E MIRATUARA

## Miratimi i Projektligjeve sipas sponsorizuesve




**Grafiku 5: Projektliqjet e miratuara gjatë vitit 2015 sipas sponsorizuesve**

#### 4.2 REFLEKTIMI I PRIORITETEVE TË QEVERISË NË AGJENDËN LEGJISLATIVE TË KUVENDIT

[illegible]

Nga ligjet e miratuara më së shumti ligje janë nga sektori i financave (12), pastaj drejtësisë (tetë), sigurisë (gjashtë), të drejtat e njeriut (katër), dhe fushat tjera si ekonomia, shëndetësia dhe tregtia (nga tri), arsimi dhe energjia (nga dy), ndërsa administratë, media, shërbime publike dhe anti-korrupsion (nga një).

#### Ligjet sipas sektorëve



**Grafiku 6:** Ligjet e miratuara në Kuvend gjatë vitit 2015, të ndara në bazë të sektorëve

Nëse krahasojmë prioritetet e Programit të Qeverisë për Vitin 2015-2018 me natyrën e projektligjeve të miratuara në Kuvend, vërejmë se në masë të madhe të njëjtat janë reflektuar në punën e institucionit ligjvënës.

Zhvillimi ekonomik, ekonomia e lirë e tregut, sundimi i ligjit, janë prioritetet që janë reflektuar më shumë në planin e përmbushur nga Kuvendi. Shëndetësi është një prioritet tjetër që është mesatarisht është reflektuar në punën e Kuvendit dhe planifikimet e Qeverisë janë përmbushur në masë të madhe. Në total, Qeveria ka paraparë miratimin e pesë projektligjeve prej të cilave dy janë miratuar dhe dy të tjera kanë mbetur në procedurë. Kurse, një projektligj nuk është sjellur fare në Kuvend nga Qeveria. Po ashtu, në sektorin e shëndetësisë është rafituar edhe një marrëveshje ndërkombëtar për reformën shëndetësore.

Programi i Qeverisë ka paraparë edhe mundësi të barabartë për qasje në jetën sociale, për çka në agjendën legjislative 2015 janë paraparë të miratohen shtatë projektligje nga ky sektor. Deri në fund të viti, Qeveria nuk ka sjellë asnjërin prej këtyre projektligjeve për shqyrtim dhe miratim. Sa i përket prioritetëve për shërbime më të mira publike, është miratuar vetëm një projektligj kurse një tjetër nuk është sjellë fare që ka të bëjë me ngrohjen qendrore. Arsimit, një prioritet deklarativ i pothuajse secilës qeveri të Kosovës, nuk është reflektuar mirë në punën e Kuvendit. Qeveria kishte paraparë të sjellë në Kuvend për miratim gjashtë projektligje, prej tyre tre të reja dhe tre tjera për plotësim/ndryshim. Në përfundim të vitit kalendarik, Kuvendi kishte arritur që të miratojë vetëm dy projektligje nga sektori i arsimit dhe një tjetër ka mbetur në procedurë, ai për arsimin e lartë. Tre projektligje të tjera nuk janë sjellur në Kuvend përkundër që Qeveria të njëjtat i ka përfshirë në agjendën legjislative.

Në procedurë nëpër komisione parlamentare kanë mbetur 23 projektligje, prej të cilave 19 janë të sponsorizuara nga Qeveria, tre nga Kuvendi dhe një është iniciativë qytetare.

#### 4.3 PROJEKTLIGJET QË NUK JANË DORËZUAR

Shikuar sipas sektorëve që i rregullojnë këto projektligje 12 prej tyre kanë qenë për administratë, nga shtatë për drejtësi, tregti dhe mirëqenie sociale, nga pesë për financa dhe energji, për arsim, siguri dhe pylltari nga tre, qeverisje lokale, bujqësi, ambient dhe kulturë nga dy dhe nga një projektligj për komunikacion, shëndetësi, sport, ekonomi, anti-korrupsion, shërbime publike, infrastrukturë dhe të drejta të njeriut.

Rolin e tij mbikëqyrës ndaj qeverisë, Kuvendi e realizon përmes instrumenteve si pyetjet parlamentare dhe interpelancat. Pyetjet parlamentare kanë qenë të pakta por edhe përgjigjet e ministrave shpesh kanë munguar. Gjithashtu edhe numri i interpelancave ka qenë i vogël. Me gjithsej 216 pyetje dhe tri interpelanca të mbajtura, mund të thuhet se Kuvendi nuk ka qenë efektiv në ushtrimin e rolit të tij mbikëqyrës.


Gjatë punimeve të Kuvendit për vitin 2015, deputetët kanë parashtruar gjithsej 216 pyetje parlamentare për kabinetin qeveritar. Prej tyre, 68 pyetje kanë mbetur pa përgjigje, kurse 148 prej pyetjeve kanë marrë përgjigje nga qeveria, apo shprehur në përqindje 68%.<sup>1</sup> Rregullorja e Punës së Kuvendit (neni 45.1) i ofron mundësinë secilit deputet që në çdo seancë plenare të parashtroj dy pyetje parlamentare. Duke marrë për bazë këtë fakt si dhe numrin e përgjithshëm të deputetëve në Kuvendin e Kosovës, mund të konstatohet se numri i pyetjeve parlamentare gjatë vitit 2015 është relativisht i ulët nëse krahasohet me mundësinë që deputetët kanë për të shtruar pyetje parlamentare.

[illegible]

|||||

Më së shumti pyetje ka pasur në sektorin e shëndetësisë (43), pasuar nga arsimi (25), administratë dhe sociale nga 21, drejtësi 13, ambient dhe siguri nga 12, financa dhe infrastrukturë nga 10, punë të jashtme nëntë, bujqësi gjashtë, ekonomi dhe kulturë nga pesë, energji, qeverisje lokale komunikacion nga katër, anti-korrupsion dhe sport nga tre, si dhe tregti, metalurgji dhe të drejta të njeriut nga dy pyetje parlamentare.

### Pyetjet parlamentar sipas sektorëve




**Grafiku 7:** Pyetjet parlamentare të parashtruara nga deputetët gjatë vitit 2015 të ndara në bazë të sektorëve

Subjekti me më së shumti pyetje parlamentare të parashtruara ka qenë VV me 78 pyetje, pasuar nga PDK me 52, AAK me 44, LDK me 24, NPK me 13, dhe deputetët pa grup parlamentar tri pyetje. Nga subjektet politike të komunitetve jo shqiptare, vetëm Lista Serbe ka parashtruar një pyetje parlamentare, kurse ato të grupit parlamentar 6+ nuk kanë parashtruar asnjë pyetje parlamentare për ministrat. Në total, nga të dhënat e mbledhura nga monitorimi i seancave plenare, mund të konstatohet se partitë opozitare ishin më aktive në aspektin e parashtrimit të pyetjeve parlamentare, me gjithsej 135 pyetje nga 216 sa janë parashtruar gjithsej.

Përgjigjet e ministrave dhënë deputetëve sipas grupeve parlamentare kanë qenë si në vijim: grupi i VV-së ka marrë 48 përgjigje, PDK 42, AAK 33, LDK 18, NPK pesë dhe deputetët pa grup (Shaip Muja) dy përgjigje. Sikurse për numrin e pyetjeve të parashtruara, partitë opozitare përsëri qëndrojnë më mirë sesa ato të koalicionit qeverisës edhe në marrjen e përgjigjeve nga kabineti qeveritar në pyetjet parlamentare të parashtruara.

|||||



Ministrat që vijnë nga LDK janë përgjigjur në 99 nga 146 pyetje parlamentare (67%), ndërsa, ministrat nga radhët e PDK-së janë përgjigjur në 44 nga 64 pyetje parlamentare të parashtuara për ta (68%).

[illegible]

|||||

Valon Murati	PDK	0	2	2
Edita Tahiri	PDK	0	1	1
Haki Demolli	LDK	0	1	1
Ljubomir Maric	SL	1	0	1

**Tabela 3: Pyetjet parlamentare drejtuar ministrave**

## 5.2 INTERPELANCAT

Gjatë vitit 2015 janë thirrur pesë interpelanca nga të cilat tri janë mbajtur, ndërsa dy të tjera kanë dështuar.

Interpelancat që kanë dështuar ishin ajo drejtuar Isa Mustafës, për përgjegjësinë e Ministrit për Komunitete dhe për Kthim, Aleksandër Jablanoviq për deklaratat e tij publike, e thirrur nga grupi parlamentar i AAK-së, dhe interpelanca për Ministrin e Bujqësisë, Memli Krasniqi lidhur me situatën e rëndë në industrinë e prodhimit të qumështit dhe produkteve të tij, e thirrur gjithashtu, nga grupi parlamentar i AAK-së.

Ndërkaq, nga interpelancat që janë mbajtur dy kanë qenë për kryeministrin Isa Mustafa, dhe një për Ministrin e Punëve të Jashtme, Hashim Thaçin. Kryeministri është thirrur në interpelancë nga grupi parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, për përgjegjësinë kushtetuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale, dhe interpelanca tjetër e thirrur nga subjektet politike opozitare për ushtrimin e kompetencave kushtetuese lidhur me nenin 94 paragrafi 1, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ministri i Punëve të Jashtme Hashim Thaçi është thirrur në interpelancë nga grupi parlamentar i AAK-së, për procesin e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.


Vlen të theksohet se Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk kufizon numrin e interpelancave që mund të thirren brenda një viti kalendarik. Megjithatë, neni 44.12 i Rregullores specifikon se interpelanca për çështje të njëjtë nuk mund të parashtrohet më shumë se dy herë gjatë një viti kalendarik.

## 5.3 MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJEVE

Për vitin 2015, Kuvendi ka planifikuar të mbikëqyrë zbatimin e 29 ligjeve, kurse deri në fund të vitit ka arritur të mbikëqyrë zbatimin e 16 ligjeve, si dhe tetë ligje të tjera kanë mbetur në procedurë të mbikëqyrjes që janë iniciuar si në vijim: Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji Kulturë, Rini dhe Sport pesë ligje, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Socila një, dhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media tri ligje. Në këtë aspekt, përkundër ngecjes në aktivitetet e planifikuara, Kuvendi ka arritur të realizoj në masë të madhe planin e vet të punës sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

|||||

## Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve



**Grafiku 9: Monitorimi i zbatimit të ligjeve sipas komisioneve parlamentare**

#### 5.4 MBIKËQYRJA E ORGANEVE TË PAVARURA

Pikë e dobët e Kuvendit në ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare është ajo e 37<sup>2</sup> Agjencive të pavarura, institucione këto të themeluara nga Kuvendi ndaj të cilit duhet të jenë llogaridhënës. Në fillim të vitit ka pasur neglizhencë nga ana e Qeverisë për të propozuar anëtarët e bordeve udhëheqëse të këtyre agjencive, kurse në pjesën e dytë të vitit është vazhduar me politizim të bordeve të agjencive të pavarura. Gjatë vitit 2015, Kuvendi ka bërë zgjedhjen e anëtarëve të 18 organeve të pavarura, që gjithsej janë 70 anëtarë.


## 6. LOJALITETI NDAJ GRUPIT PARLAMENTAR

Në monitorimin e punës së Kuvendit dhe të deputetëve individualisht, KDI ka lansuar edhe platformën Vota Ime, që ofron informata të shumta për Kuvendin. Risi e kësaj platforme ka qenë edhe matja e lojalitetit të deputetëve ndaj grupeve të tyre parlamentare, që bëhet duke i krahasuar votimet e deputetëve me qëndrimet e grupeve të tyre parlamentare. Ndonëse Rregullorja e Punës së Kuvendit garanton se deputetët nuk kanë asnjë detyrim përveç përfaqësimit të votuesve të tyre (neni 21.1), nga vlerësimi i KDI del se 68 nga 116 deputetë anëtar të grupeve parlamentare (nuk përfshihen deputetë e pavarur) janë mbi 95% lojal ndaj grupit parlamentar. Me këtë mund të vijmë në konstatimet se deputetë nuk janë shumë të pavarur në ushtrimin e mandat të tyre, dhe se grupet parlamentare kanë ndikim të theksuar në vendimet që ata marrin në Kuvend.

<sup>2</sup> Kuvendi i Republikë së Kosovës, “Lista e Agjencive të Pavarura”, *qasur më 12 shkurt 2016*. Shih: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1.1044>



### Lojaliteti i deputetëve ndaj grupit parlamentar




**Grafiku 10:** Lojaliteti i deputetëve ndaj grupeve parlamentare

## 7. UDHËTIMET E DEPUTETËVE JASHTË VENDIT

Deputetëve të Kuvendit shpeshherë u duhet të udhëtojnë jashtë vendit qoftë për të marrë pjesë në konferenca, takime, vizita studimore për të marrë praktikat e mira nga vendet më të zhvilluara, promovuar një politikë të caktuar apo lobuar për çështje të ndryshme. Shumë shpenzime të këtyre udhëtimeve mbulohen nga organizatorët, por përkundër kësaj kërkesat drejtuar Kryesisë së Kuvendit për të përfituar nga mëditjet shtesë nuk mungojnë. Përgjatë periudhës janar – tetor 2015, janë realizuar 234 udhëtime të deputetëve në 21 shtete të ndryshme. Shumica prej këtyre udhëtimeve janë realizuar në shtetet e Bashkimit Evropian, dhe vendet e rajonit. Në kontinentin e Afrikës nuk është vizituar asnjë shtet përgjatë kësaj periudhe, përkundër që në këtë kontinent janë shumë vende jo-njohëse të pavarësisë së Kosovës, dhe vizitat e delegacioneve parlamentare që hyjnë në kuadër të diplomacisë parlamentare do të mund të shërbenin për të lobuar tek këto shtete. Vlen të përmendet se shpeshherë anëtarët e delegacioneve të këtyre vizitave që vijnë nga subjekte të ndryshme politike kanë paraqitur raportime të ndryshme lidhur me përmbajtjen e takimeve të zhvilluara dhe porositë e dhënë sidomos nga përfaqësues të institucioneve të Bashkimit Evropian. Kjo ka vënë në pah mungesën e koordinimit si të mekanizmave të brendshëm të Kuvendit ashtu edhe institucioneve të ndryshme të vendit.

Sidoqoftë, dy vendet më të vizituara nga deputetët përgjatë kësaj periudhe janë Shqipëria dhe Gjermani të cilat janë vizituar nga 42 deputetë, të pasuara nga Belgjika ku kanë udhëtuar 32 deputetë. Ndërsa shtetet të cilat janë vizituar vetëm nga një herë janë Bullgaria, Polonia dhe Panamaja. Udhëtimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës në shtetet jo njohëse janë realizuara në Serbi ku kanë marrë pjesë 19 deputetë, kurse në Qipro dhe Sllovaki kanë udhëtuar dy deputetë. Në total për udhëtimet e deputetëve jashtë vendit, Kuvendi ka shpenzuar 152 mijë e 8 Euro e 50 cent. Shpenzimet janë sipas këtyre kategorive: Udhëtim/Bileta 43,219.49 Euro; Mëditje 73,017.32 Euro; Akomodim 29,392.50 Euro, dhe Shpenzime tjera: 5,690.19 Euro.

# ekonomie



*periudhën janar – tetor 2015*

e 52 cent, ndërsa shteti më i vizituar është Gjermani me 14 udhëtime të deputetëve të LDK-së.

cent.

**Legiend:**

 Numri i fluturimeve

€ Buxheti total i udhëtimeve

Numri i deputetëve që kanë udhëtuar

 Numri i deputetëve që s'kanë udhëtuar me shpenzime të Kuvendit

**Tabela 5: Planifikimi i buxhetit dhe shpenzimet e Kuvendit për nëntmujo rin e vitit 2015**

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Punën e komisioneve parlamentare gjatë vitit 2015 e kanë karakterizuar sfida të shumta, duke filluar nga mungesat e deputetëve në mbledhje, debatet jo konstruktive, si dhe akuzat ndërmjet deputetëve të partive qeverisëse dhe atyre në opozitë. Disa anëtarë të komisioneve kanë pjesëmarrje minimale nëpër takime, dhe nuk kanë marrë pjesë në diskutimet e zhvilluara.

Me fillim të sesionit vjeshtor, opozita ka filluar të bojkotojë të gjitha mbledhjet e komisioneve duke bërë kështu që shumë mbledhje të dështojnë shkak i mos përmbushjes së kuorumit të duhur për të marrë vendime në mbledhje. Gjatë kësaj kohe ka pasur një frekuencë më të shpeshtë të ministrave që kanë raportuar në komisione mirëpo diskutimet nuk kanë qenë aspak frytdhënëse dhe vetëm sipërfaqësore. Ministrat kanë raportuar për anëtarët e partive të tyre dhe kanë qenë të relaksuar pasi që nuk janë sfiduar.

Gjatë takimeve edhe anëtarët e komisioneve nuk kanë qenë të angazhuar dhe nuk janë fokusuar shumë në rrjedhën e punës. Mbledhjet kanë qenë gati jo formale dhe shumë vendime janë marrë unanimisht edhe nëse kanë pasur të bëjnë me çështje të ndjeshme.

Viti 2015 ishte një vit i varfër sa i përket numrit të seancave plenare. Ajo çfarë bie më së shumti në sy është padyshim numri jashtëzakonisht i vogël i seancave plenare në sesionin e vjeshtës, vetëm katër. Edhe këto seanca që u mbajtën nuk arritën të zhvillohen ashtu siç duhet, pasi që shumica e tyre filluan në sallën e seancave plenare dhe përfunduan në salla të improvizuara për shkak të gazit lotsjellës dhe formave tjera të protestës së opozitës. Poashtu, këto seanca nuk ishin as efektive pasi që të gjitha pikat ku kërkohej votim me 2/3 e votave apo me shumicë të dyfishtë është dashur të hiqen nga rendi i ditës për shkak të mungesës së deputetëve nga partitë opozitare. Shqetësues mbetet edhe çështja e mungesave të deputetëve në seancat plenare. Përrjashtuar sesionin vjeshtor ku opozita kolektivisht bojkotoi apo u përjashtua nga seancat, në sesionin pranveror ishin deputetët e partive të koalicionit qeveritar që munguan më shumë në seancat plenare. Janë deputetët e Listës Serbe ata që munguan më së shumti në seancat e Kuvendit, ndjekur nga ata të Lëvizjes Vetëvendosje, PDK-së e LDK-së. Megjithatë, përkundër statistikave në kuadër të Grupeve Parlamentare disa deputetë nga PDK dhe LDK ishin të vetmit që asnjëherë nuk munguan në seanca parlamentare.

Dështimi më i madh i Kuvendit gjatë vitit 2015 është padyshim mospërmbushja e rolit të tij legjislativ, pasi që agjenda legjislative e paraparë për këtë vit nuk arriti të realizohej. Vetëm 34% e projektligjeve të parapara u votuan, ndërsa 49% e projektligjeve nuk u proceduan fare. Ky fakt padyshim se do ta rëndojë edhe më tepër agjendën legjislative të vitit 2016, pasi që të gjitha ligjet e parapara për vitin 2015 të cilat nuk u proceduan në këtë vit do të barten në agjendën legjislative e vitit vijues. Poashtu, gjatë 2015-tës, shumica e atyre pak ligjeve të miratuara u miratuan me procedurë të përsheptuar gjë që krijon një praktikë të keqe parlamentare. Në fakt, mospërmbushja e agjendës së Kuvendit nuk është dukuri e viteve të fundit. Kuvendi ka probleme serioze me planifikim efikas të volumit të punës, e që më pas gjithnjë përkthehen me mosrealizim. Duke provuar efikasitetin e tij në realizimin e agjendave legjislative në vitet e kaluara, Kuvendi do të duhej t'i shmangej planifikimeve kaq "ambicioze".

Mbikëqyrja parlamentare është një nga funksionet thelbësore të Kuvendit. Gjatë vitit 2015, Kuvendi ka pasur ngecje në përmbushjen e këtij funksioni, sidomos kur bëhet fjalë për mbikëqyrjen e agjencive të pavarura. Interpelancat dhe pyetjet parlamentare si forma të ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare ndaj Qeverisë gjetën përdorim nga deputetët e Kuvendit, ndonëse jo të kënaqshëm, pasi që numri i interpelancave dhe pyetjeve parlamentare gjatë vitit 2015 ishte i vogël në krahasim me mundësitë që deputetët kishin në dispozicion.

Votimi lojal dhe trendi i dëgjueshmërisë së deputetëve ndaj preferencave të Grupit Parlamentar përkatës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Pavarësia e deputetëve me të drejtë mund të vihet në pikëpyetje, pasi që nga të gjeturat e monitorimit të punës së Kuvendit 95% e deputetëve janë treguar lojal dhe cdoherë kanë votuar në mënyrë të njëjtë me kolegët e tyre nga i njëjti Grup Parlamentar.

Me qëllim të rritjes së performancës së të gjitha trupave të Kuvendit dhe evitimit të lëshimeve të bërë gjatë viti 2015, KDI propozon rekomandimet e mëposhtme:

Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar që përbërja e komisioneve parlamentare të pasqyrojë përbërjen politike të Kuvendit. Deputetët e pavarur janë pjesë e kësaj përbërje politike të Kuvendit, por të njëjtëve sipas Rregullores aktual të Kuvendit nuk ju mundësohet përfaqësim me të drejtë vote në komisione. Andaj, gjatë hartimi të Rregullores së re të Punës së Kuvendit duhet të garantohet përfaqësim i plotë i deputetëve të pavarur në komisionet e Kuvendit.

Miratimi i Projektligjit për Kuvendin e Kosovës, është konsideruar i panevojshëm nga një grup i organizatave të shoqërisë civile aktive në punën e Kuvendit. Ndër të tjera, ky projektligj ka paraparë edhe pensionin suplementar për deputetët deri në lartësinë e 30% të pagës mujore bazë të deputetëve nëse kanë përfunduar tri mandate. Për më tepër, Gjykata Kushtetues përmes një vendimi të nxjerrë në vitin 2011, pas ankesës së parashtruar nga Avokati i Popullit me kërkesë të KDI-së, kishte konstatuar se është kundër kushtetues dhe se "pension suplementar" ka shumë tipare që më shumë i ngjajnë një dhurate suplementare pas punësimit sesa një pensioni suplementar tradicional. Andaj, në rast se projektligji për Kuvendin merr përkrahjen e deputetëve, ai duhet të ketë parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pensionin suplementar.

Është bërë praktikë e shpeshtë në Kuvend që projektligjet të kalojnë me procedurë të përsheptuar. Jo rrallë herë ka ndodhur që disa projektligje të miratohen brenda ditës në dy shqyrtimet. Mos shqyrtimi i projektligjeve sipas procedurave të rregullta dhe pa konsultimet e duhura me grupet e interesit dukshëm rritë mundësinë e lëshimeve që si pasojë ligjet pastaj mbesin të pazbatuara në praktikë. Kjo dukuri po mundësohet duke shfrytëzuar kriterin e ulët në Rregulloren e Punës së Kuvendit, që parasheh shmangien e procedurave me vetëm 2/3 e të gjithë deputetëve të pranishëm përderisa miratimi i Rregullores kërkon 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Prandaj, rregullorja e re duhet të reflektoj këtë ndryshim që edhe shmangia të mos mund të bëhet pa numrin e njëjtë të votave të deputetëve që kërkohen për të miratuar atë. Kështu, do të zvogëlohen rastet e kalimeve të projektligjeve me procedura të përsheptuar.

Me qëllim të lobimit dhe avokimit, por edhe realizimit të takimeve ndër-parlamentarë dhe pjesëmarrjes në konferenca të ndryshme, deputetët udhëtojnë jashtë vendit dhe nga këto takime duhet të dorëzohen raporte në Kryesinë e Kuvendit dhe të njëjtat diskutohen edhe në mbledhjet e komisioneve. Shpesh herë raportimi që është bërë pas vizitave, deputetët e subjekteve opozitare kanë

paraqitur raportime të ndryshme nga ata të partive në pushtet. Po ashtu, vizitat jashtë vendit nuk duhet të shërbejnë për promovime personale apo partiake por të vendit dhe të institucionit. Këto vizita nuk janë mirë të koordinuara si brenda Kuvendit ashtu edhe me mekanizmat e jashtëm institucional, siç është Ministria e Punëve të Jashtme apo Presidenca, andaj Kuvendi duhet që në radhë të parë të bëjë një koordinim më të mirë brenda vet institucionet me qëllim të shfrytëzimit efikas të resurseve dhe maksimizim në arritje të objektivave të parapara me rastin e realizimit të vizitave jashtë vendit. Që nga viti 2008 në Kuvendin e Kosovës janë ndërmarrë iniciativa për formimin e grupeve të miqësisë me qëllim të bashkëpunimit me parlamentet e vendeve tjera dhe shkëmbimit të përvojave. Në vitin 2015 Kryesia e Kuvendit ka marrë vendim për krijimin e një numri më të madh të grupeve të miqësisë përbërja e të cilave do të pasqyroj atë të Kuvendit. Grupet parlamentare janë ngarkuar të bëjnë propozimet e anëtarëve të tyre në këto grupe, por që është përcjellë me një neglizhencë të vazhdueshme për të propozuar emrat në kryesi. Andaj, grupet parlamentare duhet që në një afat sa më të shkurtër të dorëzojnë propozimet e tyre për grupet e miqësisë duhet u bazuar në kriteret e përcaktuara.

#### **5. Të ndalet praktika e propozimit të amendamenteve në seancë**

Tashmë është krijuar praktika e propozimi të amendamenteve për projektligje në seancën e njëjtë ku parashihet edhe shqyrtimi i dytë i projektligjeve. Ky lloj i propozimeve nuk është i paraparë me Rregulloren e Punës, ngase propozimet për amendamente duhet të dërgohen tek komisionet raportuese, për të shikuar nëse bijën në kundërshtim me amandamente tjera apo i plotësojnë kriteret tjera kushtetuese. Kuvendi duhet të respektoj në mënyrë rigoroz rregulloren dhe të mos lejoj amendamentet e deputetëve në seancë, por ato të bëhen përmes komisioneve.

#### **6. Planifikim më realist i agjendës legislative dhe ndërmarrja e më shumë nismave ligjore**

Planifikimi i agjendës legislative fillimisht miratohet nga Qeveria dhe përcillet në Kuvend. Komisionet e Kuvendit sipas fushë-veprimtarisë së tyre i përfshijnë në planet e tyre vjetore projektligjet e planifikuara nga qeveria. Planet e punës së komisioneve, pas miratimit i dërgohen Kryesisë së Kuvendit e cila i përmbledh të gjitha në një Plan të përgjithshëm të Punës së Kuvendit. Pra, të gjitha projektligjet e parapara nga Qeveria automatikisht përfshihen në agjendën legislative të Kuvendit. Dështimi i qeverisë për t'i sjellë këto projektligje në Kuvend shpeshherë i faturohet si dështim i Kuvendit për të përmbushur agjendën legislative. Andaj, Kuvendit duhet të ketë bashkëpunim më të mirë me Qeverinë në hartimin e agjendës legislative në mënyrë që e njëjta të mos jetë shumë ambicioze dhe përtej kapaciteteve të të dyja institucioneve për t'i hartuar dhe miratuar. Po ashtu, Kuvendi duhet të ndërmarrë më shumë nisma ligjore dhe të përfshihet në hartimin e ligjeve.

#### **7. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve**

Tashmë është bërë klishe që Kosova ka ligje të mira, por që zbatimi i tyre në praktikë nuk është duke ndodhur. Përkundër që numri i ligjeve të monitoruara në krahasim me ato të planifikuara është i kënaqshëm, Kuvendi duhet që krahas miratimit të ligjeve të reja t'i kushtoj më shumë rëndësi mbikëqyrjes. Korniza ligjore në Kosovë vetëm sa është drejt plotësimit me ligjet kryesore dhe fokusi për të ardhmen duhet të jetë në aktivitetet e shtuara mbikëqyrëse.

#### **8. Mbikëqyrje më e madhe të organeve të pavarura**

Kuvendi duhet të mbikëqyrë në mënyrë më rigoroz organet e pavarura dhe të krijoj mekanizma të përshtatshëm të raportimit dhe llogaridhënies. Emërimet e anëtarëve të bordeve duhet të bëhen në bazë të kualifikimeve profesionale dhe jo të përkatësive partiake.

#### **9. Qeveria të mos tërheq projektligjet që janë në procedurë parlamentare**

## 10. Respektimi i kohës së paraparë për fjalimet në seancë

**11. Planifikim më i mirë i buxhetit në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale, dhe raportim i detajuar i shpenzimeve**

*Rekomandimet për proceset e pa përfunduara:*

Rregullorja e Punës së Kuvendit përcakton organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit. Legjislatura e kaluar e Kuvendit ka miratuar në shqyrtim të parë Rregulloren e re por që e njëjta akoma nuk është përfunduar nga legjislatura aktuale. Kuvendi, respektivisht Komisioni për Legjislacion duhet që sa më parë të përfundoj punën e nisur për miratimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit, që është vitale për funksionim më të mirë të Kuvendit.

Qysh në vitin 2011 Kuvendi kishte miratuar një Rezolutë përmes së cilët merrte obligime të inicoi reformën e sistemit zgjedhorë. Me gjithë ngecjet, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme kishte arritur në kaloj në shqyrtim të parë por që pas shpërndarjes së Kuvendit, i njëjti nuk është riaktualizuar nga legjislatura aktuale. Reforma zgjedhore është tejet e nevojshme për avancimin e sistemit zgjedhor dhe përfaqësimin sa më të mirë të qytetarëve në Kuvend. Zakonisht, reforma është riaktualizuar në kohë të krizave politike dhe është shfrytëzuar për vazhdim të status-quo-s. Ndryshimet e sistemit zgjedhor duhet të reflektojnë nevojat dhe adresimin e pengesave të hasura dhe të njëjtat sipas Komisionit të Venecias duhet të hyjnë në fuqi një vit para datës së mbajtjes së zgjedhjeve. Kuvendi duhet që sa më

[illegible]



|||||

parë të ndërmarr hapa drejtë përfundimit të reformës zgjedhore, kurse trupat punuese duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse.

#### **14. Përzgjedhja e auditorëve të jashtëm për auditimin e financave të subjekteve politike**

Ndryshimet e bëra në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike në vitin 2013, kanë kaluar kompetencat e përzgjedhjes së auditorëve të pavarur për të audituar pasqyrat vjetore dhe ato të deklarimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në Kuvendin e Kosovës. Që nga bartja e këtyre obligimeve tek Kuvendi, financat e subjekteve politike kanë mbetur të pa auditura dhe si rrjedhojë të njëjtat nuk janë publikuar nga subjektet politike, duke u thirrur në mungesë të auditimit, përkundër që nuk ka një kufizim të tillë ligjor. KMFP duhet që sa më parë të bëjë përzgjedhje e auditorëve të pavarur kurse KBF duhet të bëjë planifikim të buxhetit për të kryer këtë lloj të auditimit duke u bazuar në çmimet e tregut.

|||||

Emërtimi i komisionit	Takimet e Komisionit	Dëgjimet Publike	Projektligje të shqyrtuara	Monitorim i zbatimit të ligjeve
Buxhet dhe Financa	41	0	49	1
Të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	30	2	41	2 (2 në procedurë)
Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	48	3	44	1
Integriteti Evropian	34	2	41	2
Punë të Jashtme	20	0	1	1
Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	35	11	10	4 (1 në procedurë)
Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	43	6	10	2
Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	23	3	2	1 (1 procedurë)
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	30	5	3	0 (3 procedurë)
Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor	26	0	1	0 (1 në procedurë)
Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Integritet	15	0	0	0
Mbikëqyrjen e Financave Publike	21	3	1	0
Të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	28	0	5	1
Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës	25	3	4	1

## ANEKSI 2: PJESEMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA PLENARE

Numri i seancat sipas muajve		3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2		
<i>Emri dhe Mbiemri</i>	<i>Grupi parlamentar</i>	<i>Janar</i>	<i>Shkurt</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qershor</i>	<i>Korrik</i>	<i>Gusht</i>	<i>Shtator</i>	<i>Tetor</i>	<i>Nentor</i>	<i>Dhjetor</i>	<i>Pjesëmarrje</i>	<i>Mungesa</i>
Adem Hozha	LS	3	0	2	0	0	3	7	1	2	3	3	2	26	21
Adem Salihaj	LDK	1	4	1	4	8	4	7	1	2	4	3	2	41	6
Adem Grabovci	PDK	3	3	2	4	9	4	8	1	1	4	3	2	44	3
Agim Ademaj	LDK	2	4	3	4	8	4	8	1	2	4	3	2	45	2
Agim Aliu	PDK	3	4	3	3	8	4	8	1	2	4	3	2	45	2
Agim Ceku	PDK	2	2	3	4	7	2	6	1	2	3	3	2	37	10
Aida Derguti	VV	3	4	3	4	8	4	5	1	1	3	1	0	37	10
Albin Kurti	VV	3	2	1	4	9	4	7	1	2	4	1	0	38	9
Albulena Haxhiu	VV	3	4	3	3	9	3	7	1	2	4	1	0	40	7
Ali Sadriu	LDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Alma Lama	LDK	3	4	3	4	0	3	5	1	1	4	1	1	30	17
Anton Quni	LDK	3	3	2	4	9	4	7	1	2	2	3	2	42	5
Arben Gashi	LDK	3	4	3	4	9	4	4	1	1	4	3	2	42	5
Armend Zemaj	LDK	3	3	3	3	9	3	6	1	2	4	3	2	42	5
Fadil Demaku	PDK	3	2	3	2	8	3	8	1	2	4	3	2	41	6
Milazim Haliti	LDK	3	4	3	4	9	3	8	1	2	4	3	2	46	1
Azem Syla	PDK	3	4	3	4	9	3	4	1	2	4	2	2	41	6
Bali Muharremaj	AAK	3	4	3	4	9	4	7	1	2	4	1	0	42	5
Bekim Haxhiu	PDK	3	4	1	4	9	1	8	1	2	4	2	2	41	6
Besa Baftiu	VV	3	4	3	4	9	4	7	1	2	4	1	0	42	5
Besa Gaxherri	LDK	3	4	3	4	9	4	6	1	2	4	3	2	45	2
Besim Beqaj	PDK	3	3	2	4	7	3	8	1	0	3	3	1	38	9
Besnik Bislimi	VV	2	3	3	1	5	0		1	2	4	1	0	22	25
Blerim Grainca	LDK	3	3	3	4	9	4	6	1	2	3	3	2	43	4
Blerim Shala	Pa Grup	3	4	3	4	8	4	6	1	2	3	3	2	43	4
Blerta Deliu	PDK	3	4	3	4	7	3	7	1	2	4	3	2	43	4
Bojan Mitić	LS	3	0	0	0	5	3	7	1	2	3	3	2	29	18
Danush Ademi	6+	3	4	3	4	9	3	8	1	2	3	2	2	44	3
Faton Topalli	VV	2	3	3	4	6	4	4	1	1	4	0	0	32	15

Daut Haradinaj	AAK	3	4	3	3	8	1	7	1	2	4	1	0	37	10
Donika Kadaj - Bujupi	AAK	3	2	3	3	9	4	7	1	2	4	1	0	39	8
Doruntinë Maloku - Kastrati	LDK	3	4	2	4	8	4	7	1	2	2	3	2	42	5
Duda Balje	6+	2	4	3	3	9	4	7	1	2	4	2	1	42	5
Salihe Mustafa	PDK	3	4	3	3	9	4	7	1	1	4	3	2	44	3
Elmi Reçica	PDK	3	4	3	4	8	4	8	1	2	4	3	2	46	1
Emilija Redžepi	PDK	2	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	46	1
Enver Hoxhaj	PDK	2	3	3	3	9	4	5	1	1	1	2	1	35	12
Etem Arifi	LDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Fadil Beka	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Fatmir Rexhepi	LDK	3	4	3	3	9	4	6	1	2	3	3	2	43	4
Fatmir Limaj	NISMA	3	3	0	1	2	2	2	1	1	4	1	0	20	27
Fisnik Ismajli	VV	3	4	2	3	8	4	4	1	2	2	1	0	34	13
Flora Brovina	PDK	2	3	3	2	9	3	8	1	2	2	3	1	39	8
Ganimete Musliu	PDK	3	4	3	4	9	4	7	1	2	4	2	2	45	2
Gëzim Kelmendi	Pa Grup	3	0	3	4	8	4	5	1	2	3	3	2	38	9
Glauk Konjufca	VV	2	4	3	4	9	3	6	1	2	3	1	0	38	9
Shaip Muja	Pa Grup	3	4	1	4	8	3	6	1	2	4	2	2	40	7
Nait Hasani	PDK	3	4	3	4	9	3	8	1	2	3	3	2	45	2
Bardhyl Meta	LDK	2	4	2	4	7	4	3	1	2	3	3	2	37	10
Hatim Baxhaku	LDK	3	3	3	4	9	4	7	1	2	4	3	2	45	2
Haxhi Shala	NISMA	3	4	3	4	9	4	7	1	1	4		0	40	7
Synaver Rysa	LDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Ilir Deda	VV	2	4	3	3	9	3	5	1	2	1	1	0	34	13
Murat Hoxha	LDK	3	4	1	3	9	4	8	1	2	4	3	2	44	3
Ismajl Kurteshi	VV	3	4	3	4	9	3	8	1	2	4	1	0	42	5
Ismet Beqiri	LDK	3	4	2	4	9	4	6	1	2	3	3	2	43	4
Jakup Krasniqi/ Enver Hoti	NISMA	1	4	3	4	9	4	7	1	2	4	1	0	40	7
Jasmina Živković	LS	3	0	0	0	9	4	6	1	2	2	3	1	31	16
Jelena Bontić	LS	3	0	0	0	9	4	6	1	2		2	2	29	18
Kadri Veseli	PDK	3	4	3	2	9	4	7	1	1	4	3	2	43	4

Kujtim Paçak	6+	3	4	3	4	9	4	8	1	2	3	3	2	46	1
Agim Kikaj	LDK	3	4	3	4	9	3	8	1	2	4	3	2	46	1
Labinotë Demi - Murtezi	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Lahi Brahimaj	AAK	3	4	2	3	7	3	5	1	2	3	1	0	34	13
Latif Gashi	PDK	3	4	3	4	9	4	6	1	2	4	2	0	42	5
Lirije Kajtazi	LDK	3	3	3	4	8	4	7	1	2	2	3	1	41	6
Luljeta Veselaj - Gutaj	PDK	3	4	3	4	9	3	7	1	2	2	3	2	43	4
Fikrim Damka	6+	2	4	3	4	8	4	7	1	2	3	3	2	43	4
Margarita Kadriu	Pa Grup	3	2	2	2	9	4	4	1	1	2		1	31	16
Melihate Tërmkolli	LDK	3	4	3	3	9	4	8	1	2	4	3	2	46	1
Hajdar Beqa	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Mexhide Mjaku - Topalli	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	47	0
Milena Miličević	LS	3	0	0	0	6	4	7	1	1	3	3	2	30	17
Milka Vuletić	LS	3	0	0	0	6	4	6	1	2	3	3	1	29	18
Mufera Srbica - Sinik	6+	2	4	3	4	8	3	7	1	2	3	3	2	42	5
Muhamet Mustafa	LDK	3	3	3	4	8	4	8	1	2	3	3	2	44	3
Mytaher Haskuka	VV	3	4	3	4	8	4	6	1	2	4	1	0	40	7
Naim Fetahu	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	2	2	46	1
Naser Osmani	LDK	0	4	3	4	9	4	8	1	2	3	3	2	43	4
Nenad Rashiq	LS	1	4	3	3	9	4	7	1	2	2	3	2	41	6
Nezir Çoçaj	PDK	3	4	3	4	8	4	7	1	2	4	3	2	45	2
Njomza Emini	LDK	3	3	3	3	7	4	7	1	1	4	2	2	40	7
Nuredin Ibishi	LDK	3	4	3	4	7	4	8	1	2	4	3	2	45	2
Nuredin Lushtaku	PDK	3	4	1	4	5	2	2	0	1	4	3	1	30	17
Pal Lekaj	AAK	3	3	3	2	9	4	7	1	2	4	1	0	39	8
Puhie Demaku	VV	3	3	3	3	6	3	3	1	1	0	0	0	26	21
Rafet Rama	PDK	3	4	3	3	9	3	8	1	2	4	3	1	44	3
Raif Qela	PDK	3	3	3	4	9	4	8	1	2	4	3	2	46	1
Ramiz Kelmendi	PDK	3	3	1	2	7	4	5	1	1	4	2	1	34	13
Ramush Haradinaj	AAK	3	3	3	3	8	3	3	1	2	4	1	0	34	13
Cerim Bajrami	6+	3	4	3	4	8	4	8	1	2	4	3	2	46	1

Rexhep Selimi	VV	3	4	3	4	7	4	8	0	2	4	1	0	40	7
Rrustem Berisha	AAK	3	4	3	4	8	4	7	0	2	4	1	0	40	7
Rrustem Mustafa	PDK	3	4	1	3	9	4	4	1	2	3	1	0	35	12
Sabri Hamiti	LDK	3	4	2	4	9	3	8	1	2	4	2	2	44	3
Sadri Ferati	LDK	3	4	3	4	9	3	6	1	2	3	3	2	43	4
Safete Hadërgjonaj	PDK	1	4	3	4	7	3	2	1	0	2	3	2	32	15
Sala Berisha - Shala	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	3	1	46	1
Salih Salihu	VV	3	2	2	4	8	4	6	1	1	4		0	35	12
Salih Morina	LDK	3	4	3	4	9	3	8	1	2	4	3	2	46	1
Saša Milosavljević	LS	3	0	0	0	9	4	7	1	1	2	3	1	31	16
Selviqe Halimi	PDK	3	4	3	4	9	4	6	1	2	3	3	2	44	3
Shpejtim Bulliqi	LDK	3	4	3	4	9	3	8	1	2	3	2	2	44	3
Shqipe Pantina	VV	3	4	3	4	9	4	8	1	2	4	0	0	42	5
Shukrije Bytyqi	NISMA	3	4	3	4	9	3	8	1	2	3	1	0	41	6
Slavko Simić	LS	3	0	0	0	6	4	8	1	2	3	3	2	32	15
Slobodan Petrović	LS	2	0	0	0	6	4	5	1	2	4	3	2	29	18
Teuta Haxhiu	AAK	3	4	3	4	9	3	7	1	2	4	1	0	41	6
Teuta Rugova	LDK	2	4	3	4	9	2	5	1	1	3	2	2	38	9
Teuta Sahatqija	LDK	3	3	3	3	8	4	8	1	0	1	2	2	38	9
Time Kadrijaj	AAK	3	4	3	4	9	4	7	1	2	4	1	0	42	5
Valdete Bajrami	NISMA	3	4	3	4	8	2	7	1	2	2	1	0	37	10
Srdjan Popoviq	LS	3	0	0	0	6	3	2	1	2	3	3	2	25	22
Veton Berisha	LDK	3	4	3	4	3	4	8	1	2	4	3	2	41	6
Visar Ymeri	VV	3	3	3	4	9	3	5	1	2	4	1	0	38	9
Vjosa Osmani - Sadriu	LDK	3	4	1	4	8	4	5	1	0	2	3	2	37	10
Xhavit Haliti	PDK	3	4	3	3	7	3	6	1	1	4	3	2	40	7
Xhevahire Izmaku	PDK	3	4	3	4	9	4	8	1	2	3	3	2	46	1
Zafir Berisha	NISMA	3	4	3	4	9	4	7	1	2	3	1	0	41	6
Zenun Pajaziti	PDK	3	2	3	3	9	4	6	1	1	3	3	2	40	7

### ANEKSI 3: PYETJET PARLAMENTARE

Deputeti/ja	Grupi parlamentar	Financa	Tregti	Ekonomi	Punë të Jashtme	Infrastrukturë	Komunikacion	Qeverisje Lokale	Energjetikë	Anti-Korrupsion	Ambient	Siguri	Drejtesi	Shëndetësi	Arsim	Administratë	Metalurgji	Sport	Kulturë	Bujqësi	Drejta të Njeriut	Sociale	Gjithsej
Bekim Haxhiu	PDK	1				1							1	7	1			3					14
Xhevahire Izmaku	PDK					1		1						3	1							2	8
Salihe Mustafa	PDK						1	1			1			2								2	7
Nezir Çoçaj	PDK					1						1			3								5
Luljeta Veselaj-Gutaj	PDK					1								2	2								5
Labinote Demi-Murtezi	PDK														1	2							3
Elmi Reçica	PDK										1			1	1								3
Blerta Deliu-Kodra	PDK													2									2
Nait Hasani	PDK	1																					1
Fadil Demaku	PDK											1											1
Ganimete Musliu	PDK															1							1
Rafet Rama	PDK										1												1
Selvije Halimi	PDK														1								1
Fadil Beka	PDK													1									1
Alma Lama	LDK		1								1		1			1			1	1		1	7
Vjosa Osmani - Sadriu	LDK				1									1		1							3
Njomza Emmini	LDK	1												1						1			3
Armend Zemaj	LDK	1									1												2
Besa Gaxherri	LDK				1						1												2
Synavere Rysha	LDK												1							1			2

40



|||||

Shukrije Bytyqi	NPK	1											2	1						2	6
Zafir Berisha	NPK									1		1									2
Haxhi Shala	NPK									1								1			2
Enver Hoti	NPK						1														1
Haxhi Shala	NPK										1										1
Valdete Bajrami	NPK														1						1
Slavko Simic	SL										1										1
Shaip Muja	Pa grup										1		2								3



INSTITUTI  
DEMOKRATIK  
I KOSOVËS



### **Rreth Institutit Demokratik të Kosovës**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

### **Rreth Projektit Vota Ime**

Projekti Vota Ime ka për qëllim që përmes monitorimit të Kuvendit të ofroj një praktikë të re të komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe deputetëve, të avancojë llogaridhënien parlamentare, përfaqësimin dhe transparencën e të zgjedhurve ndaj zgjedhësve, të gjitha këto duke shfrytëzuar edhe teknologjinë informative, përkatësisht përmes lansimit të një praktike të re të komunikimit të ndërsjellë që mundëson platforma interaktive “Vota Ime”.

Për më shumë informata rreth platformës Vota Ime ju lutem vizitoni [www.votaime.org](http://www.votaime.org)